



PRISHTINË - PRISHTINA  
**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0282**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Agon Ramadani – Kryetar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani dhe Vedat Poterqoi – Anëtarë duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Botek shpk, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit RITENDER “ Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS” me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1, me 13/09/2023, morri:

### **Vendim**

**1. Aprovohet**, pjesërisht e bazuar ankesa e OE Botek shpk me nr. 2023/0282, e datës 18/05/2023, kurse vendimi i AK MINISTRIA E SHËNDETËSISË lidhur me aktivitetin e prokurimit RITENDER “ Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS” me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1 anulohet, ndërsa lënda kthehet në rivlerësim

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Botek shpk.

### **Arsyetim**

#### **- Faktet dhe rrethanat procedurale –**

Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 03.02.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit RITENDER “ Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS” me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1.

Ndërsa me datë 24.04.2023 AK - Ministria e Shëndetësisëka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datën 28.04.2023 OE Botek sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK - Ministria e Shëndetësisë. Ndërsa me datën 08.05.2023 AK – Ministria e Shëndetësisë ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues dhe ka lënë në fuqi njoftimin mbi vendimin e AK të publikuar me datë 24.04.2023.

Operatori ekonomik ankues i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me datë 18.05.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 282/23.

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës - shërbime, vlera e parashikuar e kontratës 1,080,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrroj ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

*-Vlerësimi dhe administrimi i provave-*

OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me datë 12.07.2023 ekspertet shqyrtues kanë dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- të aprovohet ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar
- të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ri tenderojë.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit dhe ka theksuar “*Ne lidhje me Raportin e Ekspertizës 2023/0282 te datës 12.07.2023, ju njoftojmë se nuk pajtohemi me konstatimet e eksperteve, duke marr për bazë faktet dhe dokumentet e bashkangjitura në dosjen e Tenderit te ofruara për këtë aktivitet. Ne lidhje me konstatimin e eksperteve për pozitën Analist i Biznesit, ku ekspertet e kane mbështetura pretendimin ankimor të OE Botek (faqe 78, 79 dhe 80 te ekspertizës), i njëjti parim duhet të vlejë edhe për ofertën e OE të rekomanduar, i cili për këtë pozitë ka ofertuar me Z. Blerim Rexha, i cili përveç te gjitha dëshmive te prezantuara ne oferte, ku kualifikimin PhD. Andaj bazuar ne Kriteret përkatëse për këtë aktivitet ne NJK dhe DT, si dhe Sqarimet Shtese të dhëna në fazën e tenderimit, konsiderojmë qe OE i rekomanduar i plotëson te gjitha kriteret sipas kërkesave te AK. Ne dosjen e ofertuar OE i rekomanduar ka ofruar te gjitha dokumentet e listuar si ne tabelën e me sipërme dhe te njëjtat mund ti gjeni ne ofertën ne e-prokurim ( duke*



gene se bashkëngjitja e te gjitha këtyre dokumenteve si attach krijon një file shume te madh dhe është e pamundur qe te dërgohet ne këtë faze te kundërshtimit, andaj vërtetësinë e tyre mund ta bëni ne ofertën e OE ne e-prokurim). Pajtohemi me mendimin e Ekspertëve rreth dy pretendimeve te oferta e OE ankues si te pa bazuara, pasi qe edhe ne si AK-MSh ofertën ankuese e konsiderojmë te papërgjegjshme. Bazuar ne sqarimet e me sipërme dhe dokumentet faktike te kësaj dosje, AK-MSh nuk pajtohet me mendimin përfundimtar te Ekspertëve për anulimin e aktivitetit, pasi qe ofertën e rekomanduar e konsiderojmë te përgjegjshme, andaj kërkojmë qe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se.”, si dhe Operatori ekonomik nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit duke dërguar edhe email në adresë të OSHP-së ku nder te tjera ka theksuar se qëndrojnë pas pretendimeve ankimore të paraqitura me ankesë dhe kundërshtojnë raportin e ekspertit, ku ka vlerësuar jo të drejtë dy pretendime të ankesës meqë nuk janë trajtuar drejtë dhe sipas LPP, si dhe ka theksuar se raporti i ekspertit është dorëzuar jashtë çdo afati të mundshëm. OE ankues ka parashtruar edhe kërkesën për mbajtjen e seancës dëgjimore për shkak shkeljeve në këtë aktivitet të prokurimit dhe për qellim të transparencës dhe kompleksitetit të aktivitetit të prokurimit.

- Seanca dëgjimore -

Paneli Shqyrtues me datën 30.08.2023 ka mbajtur seancën lidhur me çështjen në rastin konkret ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankuese, përfaqësuesi i AK-së, në mungesë të ekspertëve shqyrtues.

*Përfaqësuesi i OE ankuese në seancë ka deklaruar:*

### **Pretendimi 1.**

Për sa i përket pretendimit të parë nga AK për eliminimin e ofertës sonë, pavarësisht faktit se sistemi HIFIS është iniciuar nga AK MSH ku është realizuar dhe implementuar me sukses ky projekt, dhe shfrytëzohet plotësisht ky sistem, në arsyetimin e eliminimit tonë, nuk japin asnjë shpjegim se vërtet çka përmban ky projekt, mirëpo deklarojnë duke mashtruar/devijuar qëllimisht:

***“System platform for HIS information System” ka te bejë me Sistemin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe nuk ka fare të bejë me Health Information System. D.m.th. projekti HIFIS ka te bejë me menaxhimin e proceseve për rimbursimet buxhetore dhe proceseve të brendshme të Fondit te Sigurimeve, ndërsa referenca e kërkuara nga MSH për HIS i dedikohet pjesës shëndetësore”.***

Kjo tregon më së miri tendencën e qartë dhe qëllimshme të AK-së, nga fillimi i vlerësimit të këtij projekti.

Sidoqoftë, ne e vlerësojmë përpjekjen e ekspertit teknik, i cili i ka marr për bazë dokumentet e dorëzuara nga ne dhe ka përshkruar me saktësi të plotë se çka vërtet përmban sistemi HIFIS - **Referenca jonë**, dhe duke u bazua ne fakte konstatohet ndërlidhshmëria e shumëfishtë e tij me HIS, citat:

*“Në këtë kontekst, OE ankuese, Botek, ka prezantuar HIFIS (Sistemi Informativ për Sigurimet Shëndetësore), i cili sipas mendimit tonë, këto dy sisteme HIFIS, megjithëse këto dy sisteme HIS dhe HIFIS janë të ndërlidhura në mënyrë të ngushtë në mes veti, shërbejnë për qëllime të ndryshme në industrinë shëndetësore, e në këtë rast janë implementuar në të njëjtin entitet, në këtë rast, Ministrinë e Shëndetësisë, në periudha të afërta kohore. HIFIS është specifik për organizatat e sigurimeve shëndetësore dhe merret me menaxhimin e informacionit dhe proceseve të lidhura me sigurimet. Pra, këto çështje lidhen ngushtë me buxhetin, statusin e pacientit, rimbursimi buxhetor që lidhet ngushtë me kostot e vizitave, si ambulatorie ashtu edhe spitalore, listën e shërbimeve të kryera dhe kostot e tyre, si dhe validimin e tyre nëpërmjet proceseve të marrë nga sistemi HIS. Ndërsa HIS është një term më i gjerë që përfshin sisteme të ndryshme informacioni të përdorura brenda organizatave të kujdesit shëndetësor për të mbështetur kujdesin ndaj pacientit, operacionet klinike dhe menaxhimin e informacionit shëndetësor. Ai bazohet në protokollet dhe procedurat shëndetësore si ICD10 dhe ICD9 në kuadër të një cikli brenda të njëjtit nivel ose ndërmjet niveleve të ndryshme shëndetësore, në rastin tonë nga Qendra e Mjekësisë Familjare deri te klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).Prandaj, edhe përkundër ndërlidhjes së këtyre dy sistemeve mes tyre, sipas sqarimeve të dhëna më sipër, mendoj se pretendimi i pare i OE ankues, është I PA BAZUAR.”*

Këtu eksperti teknik, përkundër konstatimit të mësipërm, i cili është përmbajtësor dhe i saktë, dhe tregon ndërlidhshmërinë e shumëfishtë të këtyre dy platformave, që plotësojnë njëra tjetrën, çuditërisht vjen në një përfundim absurd, duke rënë në kundërshtim me konstatimin e tij, që kjo referencë të mos merret për bazë, duke mos aprovuar pretendimin tonë.

Për më tepër, platforma HIFIS e realizuar nga ne, me sukses të plotë, konfirmuar edhe me Referencë, është projekt me kompleksitet të lartë, i zhvilluar përgjatë disa viteve, ka vlerë dhe volum dy herë më të lartë se sa sistemi ekzistues HIS.

Ndërsa sistemi HIS, sikurse kemi deklaruar edhe në ankesë, në masë të konsiderueshme nuk ka qenë funksional dhe në shfrytëzim nga institucionet shëndetësore. Për këtë arsye OE (PBC Sh.p.k) i cili e ka pas për obligim të e realizoj këtë projekt, i njëjti OE (PBC Sh.p.k.), të cilin AK e ka propozua për kontratë, NUK ka marrë asnjëherë Referencë nga vet AK-MSH. Është vërtetë për të u habitur se si AK-MSH propozon për kontratë OE-në të cilit vet AK nuk i lëshon referencë për projektin e HIS.

HIFIS është pjesë shumë e rëndësishme përbërëse e sistemit informativ shëndetësor të Republikës së Kosovës, është sistem që ndërlidhet dhe shfrytëzohet nga të gjitha institucionet shëndetësore të të gjitha niveleve në Kosovë.

I propozojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së që të kërkoj nga AK (MSH) se a ka lëshuar ndonjëherë Referencë për projektin HIS. E gjithë kjo me qëllim të vërtetimit të pretendimeve tona se AK me këtë rast MSH po kërkon Referencë nga një projekt për të cilin ajo vet NUK ka lëshuar Referencë për shkak se ky projekt nuk është realizuar asnjëherë në plotësi dhe në mes të konsiderueshme nuk ka qenë në përdorim.

Apo ta obligoj grupin e ekspertëve që të bëjnë plotësimin e Raportit të Ekspertizës duke kërkuar nga AK (MSH) informacion mbi funksionimin e këtij projekti dhe lëshimin e ndonjë reference eventuale.



Mbi bazën e të gjeturave grupi i Ekspertëve ta shqyrtoj mundësinë që të tërhiqet nga një konstatim i pabazuar dhe jo profesional.

Apo, Paneli Shqyrtues i OSHP-së të gjitha provat e dorëzuara nga ne në lidhje me këtë referencë, t'i dërgoj para cilit do institucion verifikues dhe hetimor, që të konfirmoj pretendimin tonë.

Bashkëlidhur gjeni provat, të cilat dëshmojnë që referenca jonë plotëson 100% kërkesën nga AK

*Prova 1. Referenca për projektin HIFIS*

*Prova 1.1 Lidhshmëria e HIFIS me HIS*

*Prova 1.2 Projekti HIFIS, kërkesat teknike dhe implementimi*

### Pretendimi 6 dhe 7.

Lidhur me planin dinamik të propozuar nga ne, e të cilin ekspertët, sikurse AK, nuk e kanë interpretuar drejtë, e rrjedhimisht nuk kanë dhënë shpjegim të bazuar në raportin e tyre. Ne deklarojmë se ky plan dinamik është vetëm një dokument shtesë/paraqitje grafike nga ana jonë, mirëpo i cili NUK ka qenë i kërkuar nga AK në DT.

Bazuar në dosjen e tenderit dhe në kërkesat tek *Aneksi 1. "SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME"*, pas analizave të thella të kërkesave teknike funksionale dhe jo-funksionale që janë bërë nga ekipi profesional dhe me eksperiencë të madhe në këtë lëmi, për të gjitha kërkesat që i kemi kuptuar se përpos mirëmbajtjes dhe avancimit të sistemit BHIS është kërkuar edhe zhvillim i disa moduleve të reja dhe zhvillime për avancimin e sistemit dhe moduleve ekzistuese (ne kemi dhënë plan dinamik për zhvillimin e moduleve të reja dhe avancimin e moduleve ekzistuese mbi sistemin ekzistues të prezantuar në dosjen e tenderit e JO të zhvillojmë një sistem të ri nga fillimi siç kanë pretenduar pa bazë komisioni vlerësues nga AK duke pohuar diçka që ne nuk kemi ofruar dhe as deklaruar në ofertën tonë).

Ne ofertën/zgjidhjen tonë teknike të dokumenti Plani dinamik për zhvillime, avancime dhe mirëmbajtje të sistemit ekzistues për 36 muaj dhe në ankesën tonë që kemi dorëzuar pranë OSHP-së me datë 18.05.2023 në Excel Fajllin me titull "**Plani i realizimit të projektit BHIS sipas kërkesave.xlsx**", vërehet qartë se pretendimet e AK-se nuk qëndrojnë dhe se ne nuk do zhvillojmë një sistem të ri nga fillimi. Ky dokument është paraqitur nga ne si propozim shtesë se si ne i sugjerojmë AK avancimin dhe mirëmbajtjen e këtij projekti, përgjatë 3 viteve, por pa e kufizuar në asnjë moment që i njëjti të ri definohet, përmes sqarimeve shtesë apo edhe gjatë fazës së implementimi të ndryshohet dhe përshtatet sipas nevojave të AK-së, procedurë kjo krejtësisht standarde jo vetëm në këtë projekt, por në çfarëdo projekti ku mirëmbajtja dhe avancimi janë të ndërthurura përgjatë një periudhe 3 vjeçare.

Përveç tjerash, ky dokument nuk ndërlidhet fare me pretendimin e AK, në vendimin e tyre për eliminim, pasi që nëse i referohemi Propozimit teknik të dorëzuar me ofertën tonë, në faqe 52, ne kemi deklaruar shprehimisht në lidhje me pikën: **15. Koha e Intervenimit në kërkesa- Prioriteti 4- zhvillimi i moduleve të reja jo me vonë se 20 ditë pune.**

Pra, oferta jonë teknike, është në përputhje të plotë me kërkesat e AK-së në DT, ndërsa Plani dinamik është **keqkuptuar/keqinterpretuar** qëllimisht nga AK, çka ka vënë në lajthitje edhe ekspertin shqyrtues/teknik.

*Prova 2\_Plani dinamik për zhvillim, avancim dhe mirëmbajtje të sistemit*  
*Prova 2.1\_Koha e intervenimit në kërkesa*

Fatkeqësisht, ekspertët qoftë nga ndikimet nga jashtë apo në mungesë të njohurive/përvojës, mbi trajtimin e ankesës dhe provave të prezantuara me këtë ankesë, i anashkalojnë ato qëllimisht sikurse dhe vet AK gjatë vlerësimit. E gjitha kjo na sjellë në përfundimin se është një tendencë e qartë duke provuar të nxjerrin konstatime të pabazuara dhe të njëanshme me të vetmin qëllim: *“Nëse NUK po arrihet të mbrohet në asnjë formë OE (PBC Sh.p.k.), i propozuar për kontratë e i cili përveç se NUK është i përgjegjshëm, ka ofertë financiare 100% më të lartë se oferta jonë, atëherë le të tentojmë të nxjerrim së paku 2-3 konstatime negative, për të propozuar më pas Panelit të OSHP anulimin e krejt kësaj procedure, me çka po tentohet që PSH të silllet në lajthitje”.*

Kjo tendencë e qartë nuk do duhej të pranohej assesi nga Paneli Shqyrtues, pasi që krejt kjo është një *“Kurth e ngritur qëllimisht”* dhe me këtë rast kërkojmë nga Panelin Shqyrtues që të trajtoj në detaje këtë lëndë, duke i trajtuar të gjitha provat e ofruara nga ne, të cilat faktojnë qartë tendencën e AK që të nënshkruaj kontratë me një OE (PBC Sh.p.k.), i cili është i papërgjegjshëm administrativisht (me mungesë të referencës pozitive nga vet MSH, paraqitje të certifikatave fiktive), dhe i cili ka ofertën 100% më të lartë se oferta jonë e përgjegjshme.

Pa dashur që kjo shkresë dhe kundërshtim i këtij Raporti me një gjuhë të qartë dhe të bazuar në prova dhe vetëm në prova, të keqkuptohet dhe keqinterpretohet, ne dëshirojmë të qartësojmë se për këtë procedurë do të vazhdojmë të mbrojmë të drejtën tonë, të garantuar me ligj, me të gjitha mjetet ligjore sidomos, duke pas parasysh edhe faktin se Konzorciumi i jonë GOE BOTEK-Teched-EDUSOFT, përbëhet nga kompani prestigjioze nga Kosova, Kroacia, dhe Republika e Maqedonisë së Veriut dhe të cilën kanë referenca të pakontestueshme ne punën e tyre.

*Përfundim:*

Pra, ne nuk pajtohemi edhe me 3 Konstatimet ne Raportin e Ekspertëve të lëndës dhe se të njëjtat, janë të pa bazuara!

Konsiderojmë se Paneli Shqyrtues do ta ketë mjaft të qartë se pretendimet e Ekspertit Shqyrtues dhe Teknik kanë qenë jo mjaftueshëm profesional, kontradiktor me vet konstatimet e tyre dhe të njëanshëm, prandaj propozojmë që Paneli Shqyrtues këtij Raporti të Ekspertëve to mos ia falë besimin.

Meqenëse raporti i Ekspertëve është qartazi i njëanshëm dhe kundërthënës në vetvete, kundërthënës me përmbajtjen e provave, konsiderojmë se zgjidhje e drejt dhe e ligjshme do të ishte caktimi i një Ekspertize të Re nga ekspertë të fushave përkatëse.

Pas ndërmarrjes së veprimeve të lartcekura i propozojmë Panelit Shqyrtues të OSHP që ankesën e GOE (Botek-Teched-Edusoft) ta aprovoj ne tërësi si të bazuar dhe Vendimin e Apeluar e AK të anuluj si dhe lëndën ta kthej në Ri-vlerësim.

*Përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar:*

Bazuar në takimet që kam pas me anëtarët e komisionit të gjithë anëtar qëndrojnë pranë raportit të vlerësimit me të cilin dëshmojnë se OE Botek është i papërgjegjshëm.



Arsyeja e parë qëndron mbi referencën, HIFIS dhe HIS. HIFIS është një sistem i cili është implementuar në fondin e sigurimeve shëndetësore me çka deklarojmë se ai sistem edhe sot nuk është funksional. Do thotë prej kur është implementuar ai sistem ka qenë dhe është inert vetëm në fondin e sigurimeve shëndetësore dhe nuk është përdorë as edhe njëherë.

Këtë e dëshmon edhe raporti i auditimit që ka ndodh së voni në MSH.

Fakt tjetër lidhur me HIS që kolegët potencuar se ka qenë i pasuksesshëm, me lejon të jap disa statistika. Vetëm sot HIS është i implementuar në 415 pika të ndryshme në nivel të Kosovës.

I njëjti aktualisht përdoret në kohë reale prej mbi 1500 profesionistëve shëndetësorë.

Deri sot janë regjistruar mbi 1.8 milion shërbime vetëm për vaksinim me po këtë sistem.

Janë mbi 2 milion shërbime të ndryshme shëndetësore pikërisht me këtë sistem.

Ky sistem ka shtrirje në 29 komuna të Kosovës, njëkohësisht është i shtrirë edhe në ambullanta specialitike në nivel dytësor dhe tërësor shëndetësor.

Çështja referencës për HIS, me dëshmi të kundërtën çka pretendon OE ankues, un kam qenë udhëheqës i grupit punues për implementimin e sistemit në fjalë, me çka edhe sot kur flasim as edhe njëherë të vetme nuk kemi pranuar kërkesë për lëshim të referencës për këtë produkt.

Si, kur sot të na bëhej kërkesë për referencë për këtë sistem, ne do të lëshonim referencë për projekt të realizuar suksesshëm.

Ky projekt dëshmon më së miri edhe me raporte të Bankës Botërore që në vizita e kanë vlerësuar si të suksesshëm sistemin në fjalë.

Çështja e çmimit, ju jap një arsyetim, bazuar në një analizë të MSH çmimi i paraparë nga ne ka qenë çmimi optimal i tregut sepse është kërkuar të jenë të involvuar 17 ekspert me orar të plotë pune dhe nëse kalkulimet që janë bërë bazuar në kushtet e tregut të punës një mesatare është marr 1200€ paga mujore për një ekspert, varësisht nga fusha por kjo është mesatarja, dhe vetëm me paga na del kalkulim për 900,000.00€.

Së bashku me anëtarët e grupit e kam përgatitur një fajll detaj me gjitha pikat pse OE ankues dhe të tjerët nuk i kanë plotësuar kriteret dhe të njëjtën do ja dorëzojmë tani.

Arsyeja pse nuk ka qenë i pranueshëm referenca e OE ankues, është se sistemi HIFIS nuk është sistem i njëjtë me sistemin HIS siç është kërkuar në dosje.

Sikur të bënte pyetje dhe sqarime prapë do merrte përgjigje se nuk janë sisteme të njëjta.

Në vazhdim z. Hisenaj deklaroj: janë dy kontrata të nënshkruara për sistemin HIS dhe sikur të ketë kërkesë siç cekëm në do lëshonim referencë.

Bazuar në raportin e ekspertizës referuar dosjes së OE Botek rezulton se në faqe 62 dhe 63 të pikërisht kësaj dosje plani dinamik, në kuadër të cilit qartë përshkruhet se nuk do të ketë zhvillim gjatë 36 muajve ashtu siç është kërkuar nga AK. Gjë të cilën e kanë vërtetuar edhe ekspertët e OSHP-së.

Bazuar në raportet që posedon MSH Botek dhe data Prognos kanë realizuar kontratë tillë përmes bankës botërore dhe ka qenë furnizimi njëra pjesë dhe tjetra zhvillimi sistemit për fondin e sigurimeve shëndetësore, i cili sistem ende nuk është funksional.

*Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z. Zogiani deklaroj:*

Lidhur me deklaratimet e përfaqësuesve të AK-së konsideroj se kjo seancë ka devijuar në tërësi nga qëllimi ligjorë i një seance pranë panelit shqyrtues të OSHP. Këtij devijimi të seancës i ka kontribuar fakti i mospjesëmarrjes së ekspertëve në seancë e që për neve është një mos pjesëmarrje e qëllimshme me qëllim të shmangies së ballafaqimit sepse me këtë seancë ne kemi kërkuar ballafaqim me ekspertët dhe jo me AK-në. Pra kjo seancë devijoi qëllimin e saj dhe AK e mori rolin e ekspertëve dhe përveç që u munduar ta keqinterpretoj ekspertizën të njëjtit shkuan edhe përtej asaj duke marr një rol dominant edhe ndaj qëndrimit të ekspertëve e për të cilët nuk janë palë që kanë paraqitë ndonjë kundërshtim të ekspertizës dhe gradualisht i rrëmbyen kompetencat e ekspertëve dhe pastaj i tejkaluan ato duke tentuar të mbivendosen mbi çdo palë madje edhe mbi autoritetin e OSHP-së.

Këtë po e them sepse përfaqësuesi i AK u gjend në situatë të vështirë kur o potencua fakti se OE PBC shpik nuk ka referencë dhe me një nervozizëm u mundua që këtë çështje në aspekt formal ta tejkaloj me pretendimin se kjo çështje nuk është ngritur në kërkesë për rishqyrtim por ajo çka është e evidente edhe nëse nuk është ngritur kjo çështje në kërkesë, kjo është çështje kryesore dhe si mundet një AK pa referencë dhe një mori lëshimesh tjera të marr rolin avokues të një OE të papërgjegjshëm i cili është 100% më i lartë në çmim se pala që unë sot përfaqësoj.

Pra këtu shihet tendenca e përfaqësuesit të AK, nuk përfaqëson interesin e institucionit të cili kanë detyra dhe përgjegjësi por të njëjtit e marrin rolin e avokatit të OE i cili nuk ka referencë dhe çështje tjera.

Ne jemi të kënaqur vetëm me atë që seanca është publike me audio dhe video incizim dhe kemi përvojë të gjatë në jurisprondencë dhe gjuha e trupit fletë 97% ndërsa gjuha të folurit vetëm 7%, po ta analizojmë këtë leksikologji të përfaqësuesve të AK shihet një siklet i madh se si të ja japin si ta lidhin kontratën një OE të papërgjegjshëm me çmim 100% më të lartë.

Si duket e kanë kuptuar se beteja do jetë serioze si në këtë instancë ashtu edhe në letrat dhe procedurat ligjore, andaj është e natyrshme një reagim kaq impulsiv nga ana tyre. Mirëpo përvoja dhe durimi im është i pafund.

Duke u gjendur në pozitë të pamundur të elaborojnë mungesën e referencës së OE që e kanë rekomanduar për kontratë kaluan në një fazë të ekspertimit duke e glorifikuar një sistem aq perfekt e aq funksional sa do na kishte lakmi gjithë bota dhe duke minimizuar një platformë tjetër thuajse është jo ekzistence e jo funksionale vetëm e vetëm të krijoj një elaborim jo real të situatës.

Gjatë deklaratimit të njëjtit deklaruan se kushdo të kërkonte referencë nga HIS do merrte atë referencë, po shtrohet pyetja pse nuk ju drejtuan OE PBC me këtë pyetje pse nuk e ka siguruar ky OE këtë referencë e cila qenë aq lehtë e realizueshme.

Të gjendur në këtë pozitë përfaqësuesit e AK të cilët sot ishin në cilësinë e vet shpallur të ekspertëve deklaruan se OE i propozuar për kontratë nuk ka pas referencë por ka ofruar fatura të ligjshme dhe kontratat të ligjshme dhe i dhanë vetes të drejtën dhe kompetencat që ka vetëm një



gjykatës të vlerësoj faturat a janë të ligjshme dhe kontratat a janë në harmoni me LMD apo jo dhe u munduan ti servojnë panelit idenë se në mungesë të referencës bën edhe kontrata, edhe fatura po pse jo edhe ndonjë letër tjetër. Nëse në një rast do lejohej në vend të referencave të paraqiten shkresa tjera paraqet precedent të rrezikshëm që në të ardhmen paneli ti eliminoj referencat dhe varësisht nga deponimi të pranohen letra tjera.

Nuk arritën të japin përgjigje se nuk është sistemi njëjtë, a janë të ndërlidhura, a funksionojnë njëri pa tjetrin dhe a janë të integruara të e njëjti entitet , kësaj nuk mund ti shmangen se ky do duhej të jetë në domenin e ekspertëve. Nuk mund ti japin përgjigje si në pikën 6 dhe 7 dhe dhanë keqinterpretime duke ju referuar akteve të përmendura nga të njëjtit ku deklarimet e përfaqësuesve të AK janë në kundërshtim me përmbajtjen e vet provave-akteve që ju referuan.

Përveç që rrëmbyen e rolin e ekspertëve dhe morën rolin e OE të njëjtit morën rolin e psikologut kur ju drejtuan me fjalë pronarit të ankuesit Botek se nuk e ka idenë se për çka bëhet fjalë, pra kjo tregon se AK i vlerëson në bazë të fizikutit njerëzit dhe jo në bazë të dosjes dhe nuk di mbi cilat kritere psikologjike arrijnë te konstatimet se cili person fizik ka ide e cili ska ide madje morën rolin e ligjëruesit ndaj meje që kam 18 vite përvojë me jurispodencë duke më sugjeruar se po flet si në seancë gjyqësore sepse ndoshta nga profili ekspertëve psikologjik un duhet të flas më ndryshe andaj në këtë drejtim do kërkoj të më japin se si duhet flas unë.

I propozojmë panelit që ti nxjerrin provat e përshkuara në deklaratë, ti nxjerrin vet provat me kërkesa zyrtare apo përmes ekspertëve, të caktoj në grup tjetër të ekspertëve të plotësohet ekspertiza e tyre, ankesën e palës ankues që përfaqësoj ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe vendimi apeluar të prishet dhe lënda të kthehet në rivendosje për vendosje meritore sipas provave dhe fakteve dhe harmoni me LPP.

Faleminderit për durimin dhe kërkojmë falje për çdo situatë që mund të mos ishte aq e këndshme por me sinqeritetit kësaj situatë i kontribuoj mungesa ekspertëve dhe rrëmbimi i këtij roli nga përfaqësuesit të AK dhe rolit të avokatit të OE PBC shpk.

*Kryetari i panelit z. Ramadani pyeti përfaqësuesin e OE se në kërkesë për rishqyrtim a keni ngritur pretendime ndaj OE të rekomanduar për kontratë.*

Në përgjigje përfaqësuesi i OE Botek z.Asllani deklaroi: mund të ketë pasur më pak pretendime, megjithatë po kemi pas pretendime ndaj OE PBC.

*Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK deklaroi:*

Ajo çka mund të them personalisht është se në këtë seancë nuk kam ardh të bëjë avokimin e OE e rekomanduar siç potencuar por si përfaqësues i MSH sipas pozicionit që kam.

Rekomandimi i OE fitues e ka bërë një komision vlerësues profesional dhe ne si përfaqësues i AK-së duhet të mbrojmë vendimin tonë.

Në fjalën time ceka konstatimet e komisionit vlerësues dhe assesi nuk ke qëllimi avokimit ndaj OE e aq më pak i shpifjeve siç pretendon OE.

Personalisht i besoj mendimit profesional të OSHP-së dhe presim vendim meritore sipas ligjit i cili do jetë i pranueshëm për neve pavarësisht çfarë do jetë ai.

*Përfaqësuesi i AK z. Hisenaj deklaroj:* bazuar në raportin e komisionit vlerësues dhe fakteve dhe argumenteve për këtë aktivitet qëndrojmë pranë raportit të vlerësimit. Për ato që u deklaruan për dy sistemet, u mundova të elaboroj sistemet HIFIS dhe HIS, dhe përfaqësimi jonë bëhet për institucionin dhe gjithçka lidhet me institucionin.

*-Mendimi i ekspertit shqyrtues-*

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues profesional dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ri tenderojë.

*-Konstatimet e panelit shqyrtues-*

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësas dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk vepruar konform dispozitave të cituara si më poshtë, t. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Andaj, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertëve shqyrtues dhe mendimi i tyre janë të pranueshme në mënyrë të pjesërishtme nga ana e këtij paneli, për faktin se në këto raporte është konsideruar se në disa pika të caktuara nuk përmbajnë argumente, të gjetura dhe fakte të mjaftueshme që si rrjedhojë sjellin rekomandime të qarta, andaj është arritur deri tek vendim-marrja përfundimtare që aktiviteti kthehet në rivlerësim dhe i njëjti të zhvillohet në relacion me pretendimet e paraqitura dhe vërtetimin e të njëjtave kundrejt eliminimit të OE ankues nga ky aktivitet prokurimi, andaj PSH konstaton se mbështet të gjeturat e ekspertizës në të gjitha pikat, **përveç** pikave të mëposhtme, paneli nuk ka gjetur mbështetje në raportin e ekspertizës, andaj, AK obligohet të ndërmarrë veprimet e shtjelluara si më poshtë:

Lidhur me Pika 1 - Bazuar në kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT), aneksit dhe përshkrimin e detyrave, është kërkuar përvojë në zhvillimin dhe implementimin e një sistemi HIS (Sistemi Informativ Shëndetësor), duke dëshmuar me një kontratë ose referencë për një sistem HIS. Në këtë kontekst, OE ankuese, Botek, ka prezantuar HIFIS (Sistemi Informativ për Sigurimet



Shëndetësore), i cili sipas mendimit të ekspertëve shqyrtues, megjithëse këto dy sisteme HIS dhe HIFIS janë të ndërlidhura në mënyrë të ngushtë në mes veti, shërbejnë për qëllime të ndryshme në industrinë shëndetësore, e në këtë rast janë implementuar në të njëjtin entitet, në këtë rast, Ministrinë e Shëndetësisë, në periudha të afërta kohore, ndërsa AK ka eliminuar me arsyetimin se projekti i dorëzuar nuk përbën ngjashmëri me aktivitetin konkret,

Si dhe lidhur me Pika 2 - D – për të cilën ekspertët shqyrtues kanë deklaruar se Provat e deponuara, bazuar në listën të cilën e ka prezentuar OE ankues shifet se operatori ekonomik ka përvojë në zbatimin e së paku dy (2) sistemeve të raportimit, të paktën në një organizatë me mbi 100 punonjës, ndërsa i njëjti është eliminuar me arsyen se nuk ka plotësuar kërkesën relevante.

Lidhur me dy çështjet e ngritura si më sipër, paneli shqyrtues ka arritur në konstatimin se nuk ka qenë e mundur deri tek arritja e vendosjes përfundimtare për faktin se përveç mangësisë argumentuese nga ana e AK-së lidhur me eliminimin e OE ankues mbi këto pika, poashtu duke u nisur pesha e argumenteve, sqarimeve dhe fakteve të paraqitura nga palët janë konsideruar si të mangëta e poashtu me përmbajtje kundërtë në parim, andaj PSH konstaton se gjatë procedurës së rivlerësimit lidhur me këto pika obligohet AK që të vërtetojë edhe njëherë në mënyrë më të detajuar dhe të arsyetuar, qoftë edhe nga një palë e tretë, në aspektin teknik se a përmbushen këto kritere nga ana e OE ankues plotësisht, kështu duke qartësuar situatën në aspektin teknik në mënyrë që të arrihet në një konkludim të qartë të mbështetur në analiza profesionale.

Poashtu edhe lidhur me pikat 6 dhe 7, lidhur me kohën e realizimit të projektit, me të cilën ekspertët shqyrtues kanë deklaruar se, sipas DT, specifikimeve teknike është kërkuar mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit, duke përfshirë zhvillimin e moduleve të reja dhe avancimin e moduleve ekzistuese. Është kërkuar që disponueshmëri për zhvillim të jetë sa e plotësojë kontrata valide, pra 36 muaj, duke specifikuar që zhvillimi i moduleve të reja të mos vonohet më shumë se 20 ditë pune. Megjithatë, bazuar në planin dinamik, OE ankues nuk plotëson kërkesën që të jetë i disponueshëm në çdo kohë brenda kontratës në zhvillimin e moduleve të reja gjatë validitetit të kontratës, ndërsa OE ankues ka kundërshtuar duke pohuar se në përmbajtje të dokumentacionit mund të evidentohen sqarimet e dhëna mbi këto pika, andaj lidhur me këtë, PSH konstaton se përgjatë procedurës të rivlerësimit, duke aplikuar nenin 72 të LPP-së, të vërtetojë këto pretendime ankimore duke i konsideruar sqarimet dhe deklaratimet e ofruara nga ana e OE ankues.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paraqitura kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, PSH ka arritur në konstatimin se nuk do të lëshohet në trajtimin e tyre për faktin se në kërkesën për rishqyrtim është evidentuar se nuk është ngritur asnjë pretendim ndaj OE të rekomanduar, andaj PSH konstaton se kjo bie ndesh me nenin 64.2 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik, me të cilin saktësohet se: *“Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar “Ankesat”. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.”*, andaj me qenë se OE ankues nuk i ka paraqitur këto

pretendime në kërkesën për rishqyrtim, duke u bazuar në dispozitën e referuar e poashtu duke u bazuar në frymën e konsistencës së vendimeve me situatë të ngjashme të bordit aktual, PSH konstaton se këto pretendime nuk mund të trajtohen, megjithatë meqenëse ky aktivitet kthehet në rivlerësim, mbetet në përgjegjësi të plotë të AK-së që të vlerësojë dhe ekzaminojë ofertat konform dispozitave të LPP-së në relacion me pretendimet ankimore të OE ankues.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Agon Ramadani**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- OE - **Botek shpk**
- Arkivës së OSHP-së: